



Pranuar / Dorezuar Pratjeno/Protuto Received/Delivered	24.12.2020	0	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHCK	3303/2020		1/1



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A 356/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani, kryetar, Malsore Gashi, dhe Arben Mehmeti, anëtarë, me Sabile Avdyli, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.356/2020, të datës 13.11.2020, të parashtruar nga [REDACTED], me adresë banimi Rr. „Garibaldi“, Nr. 61, 10000, Prishtinë, e përfaqësuar nga Avokati [REDACTED] me seli në Prishtinë, kundër organit të punësimit Ministria e Infrastrukturës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 03/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 24.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa A.nr.356/2020 e datës 13.11.2020, e parashtruar nga ankuesja [REDACTED]

A r s y e t i m

[REDACTED], me datë 13.11.2020 ka parashtruar ankesën me Nr.prot: 2570/2020 e regjistruar me numër A.nr.356/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimore se ankuesja ka plotësuar kushtet ligjore për deklarimin e statusit të nëpunësit civil, sipas nenit 8 lidhur me nenin 83 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit NR.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe nenit 4 paragrafi 3 dhe 4 të Rregullores NR.10/2020 për Deklarimin e Statusit të Zyrtarëve Publikë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 20.11.2020, ka dërguar tek Ministria e Infrastrukturës, kërkesën për përgjigje në ankesë, ndërsa me datën 04.12.2020, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosje në mënyre meritore ka administruar këto prova: Ankesën A nr.356/2020, e datës 13.11.2020, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-maili i datës 13.11.2020 e dërguar Këshillit; Autorizimi i datës 06.10.2020; Kërkesë e datës 09.10.2020, drejtuar Departamentit për Patent Shofer-Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore; Përgjigje në kërkesë e datës 12.10.2020; Kërkesë e datës 14.10.2020, drejtuar Ministrisë së punëve të brendshme-Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publik DMZP; Njoftimi i datës 20.10.2020; Prova shtesë të datës 16.11.2020; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 24.05.2018; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 26.06.2019; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 19.07.2019; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 05.12.2016; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 01.06.2017; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 04.09.2017; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 01.11.2017; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 31.12.2019; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 09.07.2020; Aneks marrëveshje e datës 23.07.2020; Pasqyra e Trustit të pensionit i datës 01.10.2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2018; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2019; Përgjigje në ankesë e datës 04.12.2020; Objektivat e punës për vitin 2019; E-mail i datës 10.04.2018; E-mail i datës 13.04.2018; Raporti i komisionit përzgjedhës i datës 26.04.2018; Njoftimi datës 23.04.2018; Njoftimi i datës 17.04.2018 për kandidatin e suksesshëm; Form.MAP-SHCK-08a; Form.MAP-SHCK-09;Form.MAP-SHCK-10; Form.MAP-SHCK-05; Form.MAP-SHCK-07a; Vendimi i datës 05.04.2018 për emërimin e komisionit përzgjedhës; Lista e ngushtë; Form.MAP-SHCK-04; Diplomë e datës 05.07.2012; Dëftesë 25.05.2012; Dëftesë e datës 20.06.2011; Dëftesë 10.06.2010; Diplomë i datës 27.02.2018 lëshuar nga Universitetit të Strugës; Certifikata; Konkursi i datës 20.03.2018; Autorizim i datës 06.10.2020.

Kolegji për Shqyrtim dhe Vendosje të Ankesave, pasi ka shtjelluar dhe shqyrtuar të gjitha shkresat e parashtruar nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses, *është e pa bazuar sepse:*

Kolegji konstaton se janë plotësuar të gjitha kushtet për shqyrtimin e ankesës, në kuptim të pranueshmerisë së saj, siç përcaktohet me nenin 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenin 83 paragrafi 17 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji ka analizuar pretendimet ankimore të ankuesit, i cili pretendon se ka plotësuar të gjitha kushtet ligjore, që ti pranohet deklarimi i statusit të nëpunësit civil sipas nenit 8 dhe nenit 83 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L- 114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores NR.10/2020 për Deklarimin e Statusit të Zyrtarëve Publikë, duke kërkuar nga Këshilli që të miratoj në tërësi ankesën e saj.

Gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se ankuesja, pa procedure të thjeshtësuara ka krijuar marrëdhënie kontraktuale (si ofruer i shërbimeve) me Ministrinë e Infrastrukturës (si porositor i shërbimeve), për kryerje të shërbimeve administrative në kuadër të Njesisë Rajonale të Patentë Shoferit në Ferizaj, në kohëzgjatje prej: 15.12.2016,15.03.2017; 03.03.2017-31.05.2017; 01.06.2017-31.08.2017; 04.09.2017-31.10.2017; 01.11.2017-31.12.2017; 31.01.2018-31.03.2018. Ndërsa me procedurë të thjeshtësuara, sipas konkursit publik me numër reference ref.05/2018/MI/DPSH/MSHV ka

krijuar marrëdhënie kontraktuale me Ministrinë e Infrastrukturës, në kohëzgjatje prej: 01.06.2018-30.11.2018; 01.12.2018-31.05.2019; 01.06.2019-30.11.2019; 01.12.2019-31.05.2020; 30.06.2020-29.10.2020 dhe aneks kontrata për zgjatje të marrëveshjes së fundit, deri me datë 30.11.2020.

Nga shkresat e lëndës kolegji gjenë se ankuesja ka dy vlerësime pozitive për vitin 2018 dhe vitin 2019, nga Koordinator i Njesisë së Patentë Shoferit në Ferizaj.

Me datë 14.10.2020, ankuesja i është drejtuar me shkrim Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik (DMZP), në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, me kërkesë për deklarimin e statusit të nëpunësit civil. DMZP me datë 20.10.2020, përmes e-malit ka ofruar përgjigje me sqarimin se ankuesi pasi që nuk ka kontratë të rregullt pune por marrëveshje për shërbime të veçanta, fakt ky që nuk i ka mundësuar që të ketë statusin e shërbyesit civil.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, ka analizuar dispozitat e Ligjit për Zyrtarët Publikë, përkatësisht neni 83 ku përcaktohet se: 2. *Një punonjës aktual, që nuk e ka statusin e nëpunësit civil sipas Ligjit të Shërbimit Civil (03/L-149), por që e mbanë një pozitë, e cila është pozitë e Shërbimit Civil për nga funksionet dhe përgjegjësitë sipas nenit 2, paragrafit 3 të këtij ligji, do të emërohet si nëpunës civil sipas këtij ligji, nëse i plotëson këto kushte: 2.1. ka qenë në marrëdhënie pune në një institucion të administratës shtetërore apo në një institucion tjetër shtetëror së paku dy vjetët e fundit para hyrjes në fuqi të këtij ligji ; 2.2. i plotëson kërkesat e nenit 8 të këtij ligji, dhe 2.3. është vlerësuar për rezultatet në punë në këto dy vjet të paktën "mirë".* Si rrjedhojë, Kolegji vlerëson se për deklarimin e statusit të nëpunësit civil të një të punësuar i cili nuk ka statusin e Shërbyesit Civil sipas Ligjit të shfuqizuar për Shërbimin Civil Nr.03/L-149, kërkohet që nëpunësi në fjalë të ketë krijuar një marrëdhënie pune sipas një akti të rregullt juridik respektivisht të ketë krijuar marrëdhënie pune të karakterit juridiko-administrativ, pozita e të cilit për nga detyrat dhe përgjegjësitë bazuar në Ligjin për Zyrtarët Publikë konsiderohet pozitë e shërbimit civil, marrëdhënia e punës të jetë krijuar se paku dy vjet para datës së hyrjes në fuqi të Ligjit për Zyrtarët Publikë si dhe të jenë plotësuar kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara me nenin 8 të Ligjit për Zyrtarët Publikë, i cili parasheh " *Kërkesat e përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publikë janë: 1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë për të vepruar; 1.3. të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepr penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji. 2. Përveç kushteve që parashikohen në paragrafin 1 të këtij neni, kandidatët, për t'u pranuar si nëpunës civilë, nëpunës të Shërbimit Publik dhe nëpunës administrativ dhe mbështetës, duhet t'i plotësojnë edhe këto kërkesa: 2.1. të kenë nivelin e arsimit dhe përvojën e punës të kërkuar për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 2.2. të kalojnë me sukses procedurat e pranimit, sipas këtij ligji" si dhe nëpunësi duhet të ketë rezultate të mira në punës se paku për dy vitet e fundit. Andaj, mbështetur në këtë konstatim si dhe bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji konstaton se ankuesi nuk ka krijuar një marrëdhënie juridike-administrative me Ministrinë e Infrastrukturës, por një marrëdhënie kontraktuale më qëllim të kryerjes së shërbimeve të caktuara për një periudhë të caktuar kohore, ashtu siç parashihej me nenin 12 paragrafi 4 të Ligjit të shfuqizuar Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, ku thuhet "Emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë (6) muaj do të bëhen në bazë të kontratave të quajtura "Marrëveshje për shërbime të veçanta" të cilat i nënshtrohen Ligjit për Detyrimet dhe për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit".*

Po ashtu, bazuar në nenin 84, paragrafi 1 të Ligjit NR. 06/L -114 për Zyrtarët Publikë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se marrëveshjet për shërbime të veçanta të lidhura para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të jenë të vlefshme vetëm deri në afatin e përcaktuar në këto marrëveshje ku citojmë "Marrëveshjet për shërbime të veçanta, sipas paragrafit 4 të nenit 12 të Ligjit të Shërbimit Civil nr. 03/L-149 të Republikës së Kosovës, të lidhura para hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të vlefshme deri në afatin e përcaktuar në ato marrëveshje në pajtim me dispozitat e lartcekura. Pas kësaj periudhe, marrëveshjet për shërbimet e veçanta lidhen sipas legjislacionit përkatës të prokurimit publik." Andaj, rrjedhë se pretendimet ankimore të ankueses janë të pabazuara.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave pas vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike dhe konstatimit të bazës juridike si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda Nr. A. Nr. 356/2020

Sabile AVDYLI

Sabile Avdyli

Procesmbajtëse



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses; [REDACTED]
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Infrastrukturës;
- Arkivit të KPMSHCK-së .

